



Për herë të parë Shqipëria me një Regjistër Shtetëror të Revistave Shkencore

Me hartimin e rregullores nga MAS, tashmë përcaktohen procedurat dhe kriteret për përfshirjen e revistave shkencore në këtë regjistër. Ai do të ndihmojë në strukturimin e kërkimit shkencor në fushën e publikimeve, duke e ngritur Shqipërinë në një nivel të ri për sa i përket cilësisë si dhe forcimit të ndërkombëtarizimit.



Orientimi për karrierën që në klasë të nëntë, prezantohet udhëzuesi

Udhëzuesi për orientimin e karrierës është hartuar nga grupi i punës me përfaqësues të MAS dhe institucioneve të varësisë ASCAP e DPAP. Orientimi për karrierën është një nga çështjet më të rëndësishme të politikave të arsimit e cila ka lindur si nevojë për përshtaten e individit me tregun e punës dhe aspektet e jetës sociale dhe ekonomike.



MAS dhe FSHF nënshkruajnë marrëveshjen e Programit të Futbollit për Shkollat

"Futbolli për Shkollat", një program i mbështetur nga FIFA, është i fokusuar në krijimin e skuadrave të futbollit në shkolla 9-vjeçare, furnizimin me bazë materiale të këtyre shkollave dhe trajnimin e mësuesve të edukimit fizik që më pas do të shërbejnë si trajnerë të ekipeve sportive.



Certifkohen 114 oficerë të rinj të sigurisë

114 oficerë të rinj të sigurisë përfunduan me sukses programin e trajnimit nga Akademia e Sigurisë. Tashmë numri i oficerëve të sigurisë në shkolla shkon në 220, ku krahas gjimnazeve, për herë të parë do të ketë oficerë sigurie edhe në shkolla 9-vjeçare me numër të lartë nxënësish.



"Mendimi im, Forca ime", projekti më i ri që nxit aftësitë krijuese të nxënësve

MAS prezantoi projektin më të ri, i cili ka për qëllim nxitjen e mendimit kritik dhe aftësive krijuese tek nxënësit, si dhe shkrimin bukur, saktë dhe me argumenta të gjuhës sonë shqipe.



Prezantohet Raporti i Maturës Shtetërore 2022 dhe risitë për vitin 2023

MAS prezantoi Raportin e Maturës Shtetërore 2022, arritjet dhe problematikat që do të adresohen në vijim. Krahas raportit, u prezantuan edhe risitë për Maturën Shtetërore 2023, ndër të cilat është dhe hartimi i testeve të veçanta për nxënësit me aftësi ndryshe.